**VENDIM**
**Nr. 22, datë 15.2.2017**

# MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E KONTRATËS TIP PËR SHITBLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, AKSIONET E SË CILËS KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA SHTETI DHE FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL PËR PERIUDHËN KOHORE 1.1.2017 – 31.12.2017

Në mbështetje të neneve 16, 20 germa "h" të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike"; nenit 5 të VKM-së nr. 244 datë 30.3.2016 "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike" dhe nenit 26 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.2.2017, pasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike, në lidhje me miratimin e kontratës për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/ KESH sh.a. dhe furnizuesit të shërbimit universal, OSHEE sh.a., për periudhën kohore 1 janar 2017 – 31 dhjetor 2017,

konstatoi:

- Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 244 datë 30.3.2016 "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike."
- Shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën me nr. 31125 prot., datë 23.12.2016, ka përcjellë në ERE për dijeni draftkontratën për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë KESH dhe OSHEE/FSHU, për furnizimin e klientëve fundorë për periudhën kohore 1.1.2017 – 31.12.2017.
- Shoqëria KESH sh.a. me shkresën nr. 88 prot., datë 9.1.2017 ka përcjellë në ERE për dijeni draftkontratën për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë KESH dhe OSHEE/FSHU, për furnizimin e klientëve fundorë për periudhën kohore 1.1.2017 – 31.12.2017.
- Në ERE ka mbërritur edhe shkresa me nr. 1517 prot., datë 18.1.2017 e shoqërisë OSHEE sh.a. e cila bën me dije se nuk është dakord me nënshkrimin e draftit të dërguar nga shoqëria KESH sh.a. të kontratës për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë KESH dhe OSHEE/FSHU, për furnizimin e klientëve fundorë për periudhën kohore 1.1.2017– 31.12.2017.
- Palët kanë një sërë mosdakordësish në lidhje me termat dhe kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/KESH sh.a. dhe furnizuesit të shërbimit universal/OSHEE sh.a.
- ERE me herët ka miratuar me vendimin nr.144, datë 25.8.2016, kontratën e sipërcituar për periudhën 1 korrik 2016 - 31 dhjetor 2016.
- Marrëdhënia ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. për furnizimin me energji elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal në përputhje me sa referuar më sipër, është e rregulluar.

- Çështjet për të cilat nuk kanë gjetur dakordësinë palët në procesin e negocimit të kësaj marrëdhënieje, duhet të jenë objekt i diskutimit me palët në kuadër të procedurave që ERE do të

zhvillojë deri në finalizimin e kontratës për periudhën 1 janar -31 dhjetor 2017.

- ERE duke konstatuar mosdakordësinë e palëve me njëri-tjetrin mbi draftin e kontratës për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë KESH dhe OSHEE/FSHU, për furnizimin e klientëve fundorë për periudhën kohore 1.1.2017–31.12.2017, me iniciativën e vet, propozon fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e draft kontratës së miratuar më herët me vendimin e bordit të ERE nr. 144, datë 25.8.2016.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për miratimin e kontratës për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/KESH sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/OSHEE sh.a., sipas draftit të miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 144, datë 25.8.2016, për periudhën njëvjeçare, 1.1.2017 – 31.12.2017.

2. Shtyrjen e afatit të vendosur në kontratën e miratuar nga ERE me vendimin e bordit të ERE nr. 144, datë 25.8.2016, deri në miratimin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/KESH sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/OSHEE sh.a., për periudhën njëvjeçare, 1.1.2017–31.12.2017.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a. KESH sh.a., dhe MEI për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Petrit Ahmeti**